



KRYETARI I KOMUNËS

Ekstrakt

i procesverbalit nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 21 qershor 2019

Takimi filloi në orën 10:05

Takimin e hapi dhe e kryesoi z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Në takim ishte i të pranishëm një numër i madh i qytetarëve (rreth 70 – bashkëngjitur lista e të nënshkruarve pjesëmarrës), përfaqësues të OJQ-ve, Drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të mjeteve të informimit.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, e hapi takimin duke përshëndetur të pranishmit dhe duke ju dëshiruar mirëseardhje, ndër të tjera theksoi, në bazë të dispozitave të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe të Statutit të Komunës kam ftuar këtë takim me ju qytetarë të nderuar. Tema që është parapare është:

- **Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, projektet dhe aktivitetet që janë në proces, si dhe ato të planifikuara për realizim**

Pra qëllimi i këtij takimi është që qytetarët dhe subjektet tjera të Komunës së Podujevës të informohen më afërsisht rreth punëve dhe projekteve të realizuara si dhe për planifikimet e investimeve të miratuara për vitin 2019.

Sa për informim projektet e miratuara në Kuvend, për vitin 2019 janë duke u realizuar dhe janë në proces të realizimit sipas planit dinamik. Buxheti i Komunës për këtë vit është 22,032,619.00€, prej të cilave 6,701,334.00€ për investime kapitale, ndërsa për subvencione 570,000.00€.

Edhe në këtë vit investimet kapitale kanë qenë të orientuara në projekte të ndërtimit dhe rregullimit të infrastrukturës, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës sonë.

Në vazhdim do ju njoftoj lidhur me procesin e realizimit të disa prej projekteve kapitale në Komunë, dhe atë sipas Drejtorive;

- Në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Kontratat dy vjeçare 2018-2019 janë:

- Asfaltimi i rrugëve në lagjet e qytetit (3.001 km + 2.625.60 km) - në fazën finale.
- Zgjerimi i rrugës "Zahir Pajaziti" me infrastrukturë përcjellëse - në zhvillim e sipër.
- Asfaltimi i rrugëve; Godishnjak, Lluzhan, Llugë, Siboc, Buricë, Penuhë, Sallabaj - Bugurdoll
- Majac,
- Asfaltimi i rrugëve në Dyz, Dobratin, Obrancë (Ërzhanët), Shajkoc-Xehrore (MI)
- Shtresa e parë e asfaltit, rruga buzë lumit Llap, Pakashticë - Qenogë (MI).

Projektet në realizim:

- Asfaltimi i rrugëve: Batllavë, Shajkoc (lot 1), Sfeçël, Lladoc (lot 2), Surkish, Livadicë, Balloc (Lot 3), Dumnicë e Epërme, Dumnicë e Poshtme, (lot 1), Bajqinë-Dobërdol (lot 2), Majac, Konushefc (lot 4), Bellopojë, Miroc (dy vjeçare), Herticë.
- Ndërtimi i rrugicave me kubëza në qytet.
- Rregullimi i shtratit të lumit Llap (në fazën e shpalljes),
- Ndërtimi i Bulevardit dhe Sheshit të Dëshmorëve (dy vjeçar).

- Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Projektet e përfunduara:

- Ndërtimi trotuareve në: Dumnicë e Poshtme, Halabak, Batllavë-Gërdoc dhe Peran
- Zgjerimi i lumit Kaçanolli-vazhdimi (2018/19)
- Zgjerimi i lumenjve Llap Penuhë-Konushec-Gllamnik-Llapashticë e Poshtme-Llapashticë e Epërme-vazhdimi (2018/19)
- Ndërtimi i Kanalizimi fekal (Batllavë, lagjet Hasani, Bajraktari)
- Riparimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike
- Kanalizimi fekal Dumnicë (lagja Rudarët)
- Zgjerim dhe riparimi i ujësjellësit (te Gjumnazi 'Aleksandër Xhuvani, dhe në Surkish)

Projektet në realizim:

- Kanalizimi fekal Peran (L=2,4 km)
- Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap (2018/19)
- Riparimi i rrugëve të asfaltuara
- Zgjerimi i lumit Llap (qytet-Repë), L=16,3km
- Zgjerimi i lumenjve dhe prockave (Lupç, nga lagjja Humolli-ura Lluzhan, qytet, rr. "Vëllezërit Frashëri", Bajqinë (lagjet Çitaku, Muqolli, dhe në Orllan)
- Ndërtimi i kanalizimeve atmosferike dhe kalesave
- Meremetimi i rrugëve me zhavorr
- Ndërtimi i rrethojës dhe platosë (oborrit) në hapësirat e Shërbimit të Zjarrfikjes

Projektet në procedurë :

- Ndërtimi i urës në Lupç të Poshtëm-mbi lumin Llap
- Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në Doberdol - Zakut
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në qytet dhe fshatra (mbi 40 lokacione, L=7,5 km)
- Ndërtimi i trotuareve (Lupç i Poshtëm, Sekiraqë, Siboc i Epërm, Sallabajë, Lluzhan, Gllamnik, Tërnavë, Bellopojë, Orllan, Batllavë (lagja Prokorogja), Gërdoc-Kaqybeg, Metehi, Bajqinë-Letanc, Pollatë, Revuqë, Bradash, Llaushë, Sfeqël-rruga regjionale), qytete rr."Nimon Aliu" Llapashticë e Poshtme, Kërpimeh, dhe Shajkoc - projekt 2019/20
- Ndërtimi i urave Zakut (mbi lumin Llap), Sfeçël (lagja Vokrri) si dhe në qytet (lagja Stublla, Babatinca, - mbi lumin Llap)
- Sigurimi i lumit Llap nga gërryerja (gabiona, muret mbrojtëse)-hartimi i projektit zbatues
- Ndërtimi i ndriçimit publik, Shtedim-Doganë, Orllan-vazhdim, qytet - Peran
- Ndërtimi i shtigjeve me kubza betoni në Parkun e Qytetit dhe staza te shkolla e re në Batllavë
- Rregullimi i shenjzimit vertikal

- Në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Projektet e përfunduara:

-Projekti në perimkulturë (mbështetja e fermerëve me 100 sera)

Projektet në zbatim dhe ato në procedurë:

-Projekti në pemëtari (mbështetja e fermerëve me motokultivatorë dhe pajisje përcjellëse)

-Projekti për bletari (mbështetja e bletarëve Llapjan me 1000 shoqëri bletësh)

-Projekti për mbështetje financiare të shoqatave bujqësore

-Projekti për hapjen e kanaleve ujitëse

-Projekti për analizën e tokave bujqësore.

- Në Drejtorinë e Arsimit

Projektet e përfunduara:

-Ndërtimi i objektit të shkollës “Dituria” në Llapashticë të Poshtme (në fazën finale të përfundimit)

Projektet në procedurë:

-Projekti për ndërtimin e objektit të shkollës “Elfir Behrami” në Metehi

-Projekti i ndërtimit të objektit të shkollës “Emin Duraku” në Bajçinë është në fazën përfundimtare të punimeve të vrazhda (MASHT).

-Projekti për përmirësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme shkollore në:
SHMLT “Fan Noli” (salla e edukatës fizike),

Renovimi i shkollës “Kadri Kadriu” në Dumnicë të Epërme

Renovime të pjesshme të shkollave “Dëshmorët e Kombit” dhe “Shefki Kuleta”

Renovimi i objektit të shkollës “Ali Ajeti”

Rregullimi i hapësirave të jashtme të Çerdhës “Armela”, shkollës “Dituria” dhe “Luigi Gurakuqi” në Gërdoc

Ndërtimi i fushave të jashtme të sportit për shkollën “Fan Noli” dhe “Shefki Kuleta”

Pajisja e shkollave me kabinete për lëndët natyrore (Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani” dhe shkolla “Naim Frashëri”

Furnizimi me makina industriale për pastrimin e dyshemeve për shkollat (“Aleksandër Xhuvani”, “Fan Noli”, “Naim Frashëri” dhe “DR Ibrahim Rugova”.

Instalimi i kamerave vëzhguese në shkollat: “Fan Noli”, “DR Ibrahim Rugova”, “Shaban Shala” dhe Çerdhja “Armela” në qytet, si dhe zgjerimi dhe përmirësimi i sistemit ekzistues të kamerave për vëzhgim në shkollat: “Aleksandër Xhuvani” dhe “Isa Boletini”

- Në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Projektet e realizuara:

-Furnizimi me pajisje mjekësore

-Blerja e autoambulancës

-Ndërtimi i ambulantes shëndetësore në Majac

Projektet në procedurë dhe realizim:

-Ndërtimi i objektit të emergjencës

-Ndërtimi i ambulantes shëndetësore në “Lagjen e Dëshmorëve”

-Ndërtimi i ambulantes shëndetësore në Obrançë

-Vazhdimi i ndërtimit të shtëpive në “Lagja e Dëshmorëve”

-Ndërtimi i objekteve përcjellëse (lavandari, depo dhe garazha)

-Renovimi i objekteve shëndetësore

- Në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit

Projektet në realizim:

- Ndërtimi i fushës së sporteve në oborrin e shkollës “Ali Hadri” në Obrancë
- Ndërtimi i fushës së sporteve në lagjen e ashtuquajtur Polonica

Projektet në procedurë dhe në realizim:

- Ndërtimi i Qendrës Rinore
- Zhvendosja e Bibliotekës së qytetit në objektin aktual të komunës

- Në Drejtorinë e Administratës

Projektet në realizim:

- Vendosja e kamerave të sigurisë në qytet
- Zhvendosja e administratës komunale në objektin e ri të komunës

- Në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

Projektet e realizuara dhe ato në procedurë:

- Studimi i fizibilitetit për potencialet e zhvillimit të turizmit
- Hartimi Strategjisë për zhvillimin e turizmit në Komunën e Podujevës
- Hartimi i Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2019-2021
- Përgatitja e broshurës për 100 bizneset më të suksesshme në Komunë

Të nderuar, këto që i paraqita janë vetëm disa nga projektet dhe aktivitetet e Komunës për vitin 2019, ndërsa më hollësisht rreth projekteve, investimeve dhe planifikimeve për vitin 2019 sipas fushave përkatëse do të ju njoftojnë në vazhdim drejtorët e Drejtorive.

Pas prezantimeve nga ana e drejtorëve, do të marrim vlerësimet e juaja, por edhe do të japim përgjigje lidhur me çështjet që ju shprehni interesim.

Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, theksoi, dëshiroj të jap edhe disa njoftime më të detajuara përveç atyre që paraprakisht i paraqiti Kryetari i Komunës. Për hir të opinionit, DSHPMSH ka edhe disa projekte të planifikuara për realizimin e tyre e që nuk janë përfshirë në listën e atyre që u cekën nga Kryetari, kjo për shkak se ende janë në periudhën para procedurale.

Kemi ndërtimin e kanalizimit fekal në fshatin Pakashticë e Epërme në gjatësi rreth 1500 m, pastaj kemi edhe projektin e shënjzimeve horizontale, gjithashtu kemi bërë evidentimin e të gjitha gropave të rrezikshme që janë nëpër rrugë të ndryshme, do të kemi projektin për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në 5 lokacione të ndryshme, mandej ndërtimin e urave në fshatin Peran, dhe kalesave tjera të ndryshme, do të jetë projekti vazhdim për ndërtimin e kolektorit të ujërave të zeza që përfshin edhe kolektorin e qytetit deri në përfundimin e tij, kanalizimin fekal në fshatin Herticë - lagja Bajgora, mandej ndërtimin e urave në fshatrat Pollatë dhe Pakashticë e Epërme, do të jetë vazhdimi i projektit për ndërtimin e kanalizimeve fekale në fshatrat Gllmanik dhe Siboc i Poshtëm ku disa segmente janë në procedura të prokurimit kurse disa në fazën e hartimit të projekteve. Po ashtu do kemi rregullimin e hapësirave publike si dhe ndërtimin e mureve mbrojtëse përgjatë shtratit të lumit Llap, nga fshati Lluzhan deri në qytet, të gjitha me gabione që do të rregullohet brenda 2 viteve ku edhe do të sigurohet lumi Llap ashtu siç është siguruar pjesa e poshtme.

Pra këto që u cekën janë disa projekte të cilat kemi paraparë të kryhen deri në përfundim të vitit 2019, andaj edhe e pashë të arsyeshme që mos të përsëriten gjatë diskutimeve sepse ndokush edhe mund të mendoj se ndonjë projekt është hequr nga planifikimet për vitin 2019 e që unë ju siguroj që asnjë prej tyre nuk është hequr.

Kryetari i Komunës, ftoj që të marrin fjalën të gjithë ata që kanë interesim.

Shaip Stublla, banor i lagjes Dëshmorët Stublla, paraqiti shqetësimin për dëmtimin e rrugës gjatë kryerjes së disa punimeve lidhur me investimet e bëra në kablo të energjisë elektrike.

Pastaj paraqiti kërkesë për zgjerimin e kanalizimit në atë pjesë të lagjes, dhe atë kur do që të ketë rregullim të ri të rrugës, si dhe gypin e ujësjellësit sepse siç e tha është i vjetruar. Gjithashtu potencoj se orët elektrike janë vendosur lartë në shtylla elektrike dhe kjo situatë po na e pamundëson të shikojmë shpenzimet e bëra e që t'ju them të drejtën KEDS-it nuk i besoj, madje secili në atë lagje kemi dyshime në shpenzimet e bëra, andaj pyes a kemi ndonjë mundësi ne si Komunë të ndërmarrim diçka në këtë drejtim.

Pra është investuar në atë lagje, në ndriçim publik, hapësira etj dhe është kënaqësi të shëtitësh sidomos në mbrëmje, por me ato ndërhyrje në rrugë, paksa e ka prishur kënaqësinë e banorëve.

Gani Maloku, nga fshati Majac, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës ‘‘Besa Jonë’’ rreth 200 m, dhe rrugës tjetër ‘‘Ahmet Berisha’’ që lidhë fshatin Majac me fshatin Lupç i Poshtëm dhe më gjerë, për të cilën tha se kur ka reshje atmosferike bëhet vështirë e kalueshme sidomos për nxënësit e asaj pjese por edhe paraqet vështirësi për disa toka të punueshme në atë pjesë. Pra në Majac është investuar, dhe kanë filluar tani disa investime, mirëpo për dy rrugët e cekura nuk kemi informacione.

Skender Maloku, nga fshati Lluzhan, theksoi, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës rreth 180 m, që lidhë rrugën kryesore me rrugën ku banon ai, projekt për të cilin tha se është hartuar projekti dhe i njëjti është dorëzuar në Komunë dhe disa herë është thënë nga ish drejtorët e Drejtorisë përkatëse se do të kryhet por ende nuk është duke ndodh një gjë e tillë, pra dëshiroj të dijë a është në planifikimet e Komunës të asfaltohet rruga në fjalë.

Ahmet Zeqiri, nga fshati Sfeçël, kërkoj të informohet në lidhje me kërkesën e parashtruar për rregullimin me zhavorr rrugën e lagjes ku ai jeton.

Fadil Gërguri, nga fshati Siboc i Poshtëm, theksoi, përcjella me vëmendje rezymetë e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorit të DSHPMSH, andaj dëshiroj të informohem rreth investimeve në fshatin Siboc i Poshtëm ngase sa kam vërejtur po anashkalohemi ne si fshat sa i përket investimeve, shembull, vazhdimi i rregullimit të lumit, trotuari në rrugën e quajtur Rrahmanovit, pastaj rruga në drejtim të fshatit Kaçybeg e cila ka pasë të rregullohet me zhavorr, vazhdimi i kanalizimit fekal i cili ka filluar qe 3 vite etj.

Rexhep Dauti, nga fshati Llaushë, theksoi, ne kemi një rrugë rreth 1.5 km, e cila lidhë fshatin Llaushë me fshatin Dobërdol, rrugë të cilës i është bërë baza në vitin 2012, por që ende nuk është asfaltuar. Asfaltimi i rrugës së cekur do të ishte e nevojshme për shkak se lidhën fshatrat Llaushë, Dumnicë, Dobërdol, Bajçinë, Zakutë, Kërpimeh dhe gjithë atë pjesë andej.

Pastaj kemi edhe rrugën rreth 600 m, e cila lidhë dy shkollat e fshatit e të cilës po ashtu baza i është rregulluar por që është e nevojshme të asfaltohet.

Mandej kemi lagjen Sadiku e cila është në një gjendje të rëndë sepse nuk ka të rregulluar kanalizimin, prandaj do të ishte mirë që sa më parë të jetë e munduar të ndërtohet kanalizimi i asaj lagjeje.

Ruzhdi Fazliu, nga fshati Dumnicë e Epërme, paraqiti kërkesën për investime në shkollën e fshatit Dumnicë e Epërme, konkretisht në dysheme, në funksionalizim të shtrirje së ujit, nevojëb për dyer të brendshme, si dhe asfaltimin e pjesës së rrugës prej 50 m deri tek shkolla.

Gjithashtu paraqiti kërkesën për dy rrugë në gjatësi rreth 120 m, në lagjet Dabinovci dhe Tihovci për të cilat tha se si lagje kemi rënë në dakord që ato dy rrugë të shkrihen në një rrugë dhe të asfaltohet. Po ashtu bërë kërkesë edhe për asfaltimin e rrugë në lagjen Jaholli, siç potencoj, infrastruktura tjetër në fshat është kryer përveç këtyre që u cekën.

Fahrudin Mahmuti, përfaqësues i fshatit Siboc, mora fjalën më shumë që të paraqes investimet dhe projektet e kryera nga Komuna deri tani, për çka i përshëndes Kryetarin e Komunës dhe gjithë Drejtorët e Drejtorive përkatëse për investimet e bëra, siç janë, ndërtimi i objektit të ri të shkollës, është ndërtuar fusha e sportit në oborrin e shkollës, rregullimi i rrugës nga lagja Mexhuani deri tek lagja Gërguri dhe shumë rrugë dhe rrugica tjera të cilat

vetëm tani po dalin të jenë të nevojshme sepse me punimet në magjistralen Podujevë-Prishtinë shumë vetura lëvizin nëpër Siboc. Pra ka edhe shumë investime që janë bërë dhe jemi të kënaqur si fshat, mirëpo meqë kemi kaluar nga faza emergjente që ka qenë, tani e tutje do të fillojmë me disa kërkesa që do t'i parashtrijmë në formë të shkruar nëpër secilën Drejtori përkatëse, kërkesa dhe projekte të cilat sigurisht që do të jenë në aspektin e zhvillimit, komoditetit dhe lehtësisë të jetesës së banorëve të fshatit.

Shaban Menxhiqi, nga fshati Lupç i Epërm, theksoi, dëgjova Kryetarin e Komunës dhe Drejtorin të cilët paraqitën projektet dhe aktivitetet e Komunës, por meqë nuk vërejtta se dy projekte nuk janë në planifikime për këtë vit, dëshiroj të paraqes ato në formë të kërkesës, fjala është për rregullimin me zhavorr të rrugës në gjatësi rreth 1 km, e cila është e nevojshme për 4-5 familje të fshatit dhe për punimin e tokave.

Po ashtu foli edhe për zgjerimin dhe pastrimin e lumit Kaçandoll për të cilin tha se sa kam vërejtur unë nuk është punuar si duhet, ndoshta edhe pa fajin e punëtorëve sepse ka pas kundërshtime paksa nga ana e fshatarëve, por megjithatë ja vlen të përshëndetet ai projekt.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, dua të jap një sqarim rreth këtij takimi dhe debatit që u zhvillua deri tani ngase paksa u ngatërrua tema sepse takimi është thirr për projektet që janë realizuar në këtë gjashtëmuor të parë të vitit, projektet që janë në proces dhe ato që janë në planifikime për tu realizuar gjatë këtij viti, ndërsa shumica prej parafolësve shtruat kërkesa të cilat sipas procedurave duhet të planifikohen për vitin e ardhshëm.

Nuk e di sa jeni të informuar por, ne si Komunë aktualisht jemi në fazën e hartimit të buxhetit të Komunës për vitin 2020 dhe planifikimet për 2021/2022, konkretisht për këtë kemi thirrë dhe organizuar edhe një dëgjim buxhetor para rreth 1 jave këtu në këtë sallë dhe kanë qenë të ftuar të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës për të paraqitur kërkesat dhe nevojat e tyre, ndërsa tani kur kemi të bëjmë me realizimin e projekteve dhe planifikimeve për vitin 2019 për çka edhe do të duhej të bëheshin vlerësime, u paraqiten kërkesa për vitet në vazhdim e që nuk është diçka jo e mirë kjo, por do të ishte më mirë që punët të bëhen sipas rendit. Secili nga ju mund të merrni informacione të ndryshme tek Drejtorët e Drejtorive përkatëse lidhur me nevojat dhe punët që do të kryhen në këtë apo në vitet e ardhshme. Megjithatë unë i ftoj Drejtorët të marrin fjalën dhe t'ju njoftojnë për të gjitha kërkesat që u paraqiten gjatë takimit.

Sa i përket kërkesës së parashtruar që kishte të bënte me lagjen Stublla, përkatësisht rreth dëmtimeve të rrugës nga ana e KEDS, ju them se gjatë punimeve që ata bëjnë, për çdo gjë që ajo Kompani dëmton, qoftë rrugë, trotuare etj, ne kemi një Marrëveshje që të njëjtat duhet të kthehen në gjendjen e mëparshme ashtu si kanë qenë, ndërsa lidhur me kërkesën që ishte për ndërtimin e kanalizimit dhe ujësjellësit, ne do të shikojmë mundësitë tona si Komunë, por një gjë ju them se nuk bëhen asfaltime nëse infrastruktura tjetër përcjellëse nuk është e rregulluar.

Po ashtu sa i përket vendosjes së orëve elektrike në shtylla të energjisë elektrike, mund të them se është problem që është duke ndodhur pothuajse në gjithë Kosovën ngase KEDS kanë marrë një vendim të tillë që orët t'i vendosin në shtylla, ndërsa rreth qasjes në shpenzime KEDS kanë ofruar një program telefonik enkas për qasje në të dhëna në orët elektrike ku mund ta shkarkoj secili dhe të shikoj shpenzimet e energjisë elektrike, mirëpo nëse ka dyshime në ato orë elektrike atëherë Komuna nuk është autoritet që mund të vërtetoj një gjë të tillë por është Agjencia e Metrologjisë së Kosovës që duhet t'i drejtohet secili qytetarë që ka dyshime.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, do të bëjë përpjekje të jap disa sqarime rreth atyre kërkesave që u paraqiten gjatë këtij takimi, edhe pse mund të them lirshëm se disa prej përfaqësuesve të fshatrave janë në dijeni për ato çështje, por që sërish i ngritën disi me dyshime se a do të bëhen apo jo.

Sa i përket z.Shaip Stublla, i cili paraqiti problemin me gypin e ujësjellësit dhe gypin e kanalizimit, shpresoj që këtë vit do të kryhen dhe po ashtu kurrsesi nuk do të shtrohet asfalti pa u kryer ato dy çështje.

Sa i përket çështjes që z.Gani Maloku e paraqiti, nëse mendohet për rrugën nga ura deri tek lagja Retkoceri, rreth 1.2 km, ajo do të trajtohet në këtë vit me zhavorr, kurse për asfaltimin e saj mund të jepen informata nga Drejtoria përkatëse, e që unë do të bisedoj me Drejtorin e DPUMM rreth rrugës që ju e paraqitët.

Sa i përket z.Ahmet Zeqirit, ne jemi duke punuar këtë vit që rrugët që janë në gjendje jo të mirë të rregullohen me zhavorr brenda muajit korrik, e që edhe ajo rrugë që e cekët do të jetë në planifikim.

Sa i përket z.Fadil Gërgurit, i cili tha se po anashkalohe mi si fshat, nuk qëndron ajo sepse ka pasë dhe do të ketë investime në fshatin Siboc i Poshtëm, tani mund të them se vitin e kaluar nuk na është lejuar nga banorët të kryhet kanalizimi në gjatësi rreth 300 m, ndërsa tani sërish kanë kërkuar të kryhet ai projekt, pastaj në këtë vit kemi në planifikime ndërtimin e urës që ka qenë kërkesë e juaja ashtu siç e kemi edhe pastrimin e lumit i cili do të filloj brenda dy – tri ditëve, por që duhet ta pranoni se po kemi probleme me një pjesë të banorëve atje, por fundja me asistencë të policisë ato projekte do të kryhen. Në vitin e ardhshëm kemi në planifikime një pjesë të madhe të ndërtimit të trotuarit në rrugë të ndryshme të fshatit Siboc i Poshtëm.

Sa i përket z.Rexhep Dauti, përfaqësues i fshatit Llaushë, kemi dashtë të fillojmë punimet për ndërtimin e kanalizimit rreth 2 km. por që kemi ndaluar punimet për shkak se nuk është përfshirë edhe lagja Sadiku sepse sipas kërkesës tuaj nuk është paraparë kanalizimi i asaj lagjeje, kurse ne do ta përfshijmë dhe atë.

Sa i përket asaj që z.Ruzhdi Fazliu e ceku për fshatin Dumnicë e Epërme, ne disa herë ju kemi thënë që këtë vit do të filloj dhe përfundoj ndërtimi i kanalizimit në lagjen Jaholli, gjë të cilën jua kemi thënë edhe përfaqësuesve të asaj lagjeje para rreth 1 jave në dëgjimin publik që ka qenë. Në fshatin Siboc të Epërme, në këtë vit do të vazhdoj trotuari në disa rrugë.

Sa i përket kërkesës së z.Shaban Menxhiqi, inxhinierët e Komunës janë duke janë duke evidentuar të gjitha rrugët që kanë nevojë për rregullimin e tyre me zhavorr, pastaj bëhet një vlerësim dhe do të shohim nëse edhe ajo do të hyn në planifikime në këtë vit.

Në fshatin Metergoc, këtë vit është në planifikime rruga rreth 500-600 m, e cila qon në drejtim të një ferme, kurse sipas vlerësimeve që kemi bërë rruga kryesore nuk mund të mbahet me zhavorr sepse pas reshjeve ajo sërish kthehet siç ka qenë për shkak të terrenit që është në atë pjesë, mirëpo sigurisht që do të vie dita që edhe ajo rrugë do të asfaltohet në faza, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Infrastrukturës.

Kështu që ju falënderoj për këto kërkesa që paraqitët edhe pse pothuajse rreth 95 % e tyre janë të planifikuara për realizim në këtë vit, edhe pse për të gjitha këto është mirë të jenë të informuar përfaqësuesit e fshatrave sepse edhe në vitin e kaluar ka pas debate, kërkesa, dhe janë informuar secili për projektet që janë përfshirë në buxhetin e Komunës për këtë vit që jemi, pasta edhe para rreth 1 jave janë paraqitur të njëjtat në dëgjimin buxhetor që është mbajtur, mirëpo pavarësisht kësaj urdhëroni pyetni nëpër drejtoritë përkatëse rreth investimeve dhe projekteve në fshatra, lagje të qytetit dhe të fshatrave.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, nëse ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe për kontributin e dhënë.

Takimi përfundoi në orën 11.00

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr. 02-060/04-0050006/19
Podujevë,
21 qershor 2019**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**